



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 288 prot.

Tiranë, më 11.01/2018

URDHËR

Nr. 52, Datë 11.01/2018

PËR

**EKZAMINIMET DHE ORGANIZIMIN E KOMISIONEVE MJEKËSORE  
RAJONALE TË CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbështetur në ligjin nr. 9106, datë 07.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar",

URDHËROJ:

1- Spitalet Rajonale duke filluar nga data 05/01/2018, të kryejnë ekzaminimet për rikomisionimin pranë Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë Rajonale, si vijon:

- Për sëmundjet kardiake EKG, ECHO zemre, Provë ushtrimore, Holter, ekzaminime laboratorike (gjak komplet, azotemi- kreatinemi, AST- ALT, lipidogramë, glicemi);
- Për sëmundjet neurologjike CT, ENG, ENMG, EEG;

- Për sëmundjet patologjike, ECHO abdominale, ekzaminime laboratorike;
  - Për sëmundjet onkologjike, ECHO, CT, Markues tumoral;
  - Për sëmundjet e shëndetit mendor, konsulta e specialistit pranë Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor;
  - Për sëmundjet e syve, fundus okuli, OCTA, Visus me dhe pa korrigjim, fusha visive;
  - Për sëmundjet pulmonare, Ro grafi pulmoni, CT, Provat respiratore;
  - Për sëmundjet ORL, CT, MRI;
  - Në ato spitale ku këto ekzaminime mungojnë do të bëhen sipas sistemit të referimit të FSKDSH.
- 2- Spitalet Rajonale duhet të përditësojnë të dhënat mbi numrin e ekzaminimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri.
- 3- Ky informacion duhet të dërgohet çdo muaj pranë Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Programeve të Zhvillimit të Shërbimit Spitalor.
- 4- QSUT "Nënë Tereza", do të pranojë pacientë për ekzaminime të mëtejshme vetëm pasi të jenë referuar paraprakisht nga mjekët e spitaleve rajonale.
- 5- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Spitalet Rajonale, QSUT "Nënë Tereza" dhe FSDKSH.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**OGERTA MANASTIRLIU**

**MINISTER**

